



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 624/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje prej: Kimete Gashi - Kryetare, Agon Ramadani - Anëtar dhe Vedat Poterqoi Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik (OE) "BBROS L.L.C", me seli ne Prishtinë, lidhur me aktivistin e prokurimit me titull: "Sistemi i menaxhimit elektronik të automjeteve me pajisje GPS", nr.prokurimit,616-22-11430-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës, me datë 26.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik, "BBROS L.L.C", me seli ne Prishtinë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me numër protokollit 624/2022 me datën 01.11.2022, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Sistemi i menaxhimit elektronik të automjeteve me pajisje GPS", nr.prokurimit,616-22-11430-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës.

II. OBLIGOHET, Autoriteti Kontraktues për aktivitetin e prokurimit "Sistemi i menaxhimit elektronik të automjeteve me pajisje GPS", nr.prokurimit,616-22-11430-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës të bëjë ndryshimet e nevojshme për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara.

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues të OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, të precizuar me numër dhe datë si në paragrafët paraprak të dispozitivit të këtij vendimi.

IV. OSHP mund të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/ L-068, dhe Ligjin 05/L-092.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues, “BBROS L.L.C”, me seli në Prishtinë aprovet si e bazuar i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Komuna e Prishtinës në cilësinë e autoritetit kontraktues me datën 18.10.2022, ka publikuar njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sistemi i menaxhimit elektronik të automjeteve me pajisje GPS”, nr.prokurimit,616-22-11430-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës.

AK ka parashikuar afatin për dorzimin e ofertave me datën 07.11.2022, kërkesa për ri shqyrtim në AK me datë 01.11.2022, si dhe përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të OE ankues me datë 07.11.2022

I pakënaqur me vendimin e AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim, OE ankues “BBROS L.L.C”, me seli ne Prishtinë, me datën 04.11.2022 ka parashtruar ankesë në OSHP ,ankesë kjo e protokolluar në OSHP me dt.07.11.2022.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 62 296.00 €.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrorjë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe e njëjta bije nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

OSHP ka angazhuar ekspertin e jashtëm shqyrtues të prokurimit që në pajtim nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili në raportin e datës 22.12.2022 ka rekomanduar që:

- aprovohet si e bazuar ankesa e OE ankues “BBROS L.L.C”, në Prishtinë
- anulohet në tersi aktiviteti i prokurimit i lartë shënuar.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Përshkrim i përgjithshëm i aktivitetit të prokurimit

Autoriteti Kontraktues, me anë të këtij aktiviteti të prokurimit publik, ka për synim nënshkrimin me një OE ose GOE të një kontrate për implementimin e një sistemi me qëllim të monitorimit në kohë reale dhe retroaktive të automjeteve, menaxhimit e përdorimit të automjeteve, evidentimit të shpenzimeve të mirëmbajtjes si dhe evidentimeve të shpenzimeve të karburanteve.

Eksperti shqyrtues teknik, duke analizuar dhe kontrolluar ankesën dhe faktet e bashkëngjitura me të, konstaton se AK tashmë ka të instaluar produkte/aplikacione të cilat ofrojnë/kryejnë shërbime për të cilat është iniciuar ky aktivitet i prokurimit dhe po ashtu konstaton se të njëjtat edhe janë mirëmbajtur në tri vitet e fundit, pra ka pas kontratë publike kornizë për mirëmbajtje në kohëzgjatje prej 36 muajsh.

Pretendimet Ankimore

OE ankues në Ankesën me numër P.SH. 624/22, pretendon së gjatë udhëheqjes se këtij aktiviteti të prokurimit publik AK ka vepruar në kundërshtim me nenet 1, 6, 7, dhe paragrafët 2 dhe 6 të nenit 108/A të Ligjit nr. 04/L-042 për prokurim publik dhe në kundërshtim me nenin 20 të RRUOPP-së konkretisht me paragrafët 4 dhe 8 të tij.

Ekspertet shqyrtues të prokurimit në pajtim me autorizimet e mundësuar për ta nga ana e LPP-së, konkretisht nenit 114 të Ligjit 04/L-042 i plotësuar, ndryshuar, i kanë shqyrtuar dhe analizuar pretendimet e përmbledhura ankimore të OE ankues dhe për të njëjtat i kanë këto të gjetura, konstatime dhe rekomandime, si në vijim:

Pretendimi Ankimor 1:

Autoriteti Kontraktues ka shkelur Neni 1 dhe 6 të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

- Autoriteti Kontraktues nuk ka marrë të gjitha masat e nevojshme për tu siguruar që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.
- Autoriteti Kontraktues, ka kërkuar furnizimin me pajisje harduerike për këtë procedurë të prokurimit: II - Pjesa Harduerike

- Autoriteti Kontraktues, përveç dëmtimit të buxhetit që është e ndaluar me nenin I të Ligjit për Prokurim Publik, këtë kërkesë e ka vendosur për të favorizuar vetëm një operator ekonomik i cili arrin të marrë autorizimin e prodhuesit për pajisjet e përshkruara të pjesa II - Pjesa Harduerike

Përgjigje në pretendimin 1:

Ekspertët shqyrtues lidhur me këtë pretendim ankimor, duke u bazuar në dëshmitë e ofruara nga OE ankues mbi kontratat paraprake të iniciuara nga AK lidhur me furnizimin dhe pastaj edhe me mirëmbajtjen e këtij sistemi (të dyja këto kontrata publike kornizë me kohëzgjatje 36 muaj), konsiderojmë që AK ka bërë shkelje të Neneve 1 dhe 6 të LPP-së duke iniciuar njoftimin për kontratë në të cilin përfshihet furnizimi me pajisje të tjera, pra, duke mos përdorur fondet dhe burimet publike në mënyrën më ekonomike, ngase pajisjet që Autoriteti Kontraktues tashmë i posedon nga kontrata paraprake, për mendimin tim përmbushin qëllimin e projektit në fjalë, kjo nga vetë fakti që pas furnizimit të pajisjeve është iniciuar dhe përmbyllur edhe procedura e re e prokurimit për mirëmbajtjen e të njëjtave, prandaj propozoj që pretendimi ankimor 1 të aprovohet si i bazuar nga ana e panelit shqyrtues të OSHP-së.

Pretendimi Ankimor 2:

Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 7 të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, sepse:

1. Autoriteti Kontraktues, ka favorizuar një operator ekonomik, duke kërkuar
 - 1 (një) menaxher të projektit me përvojë pune minimumi 5 vite në këtë lëmi;
 - 2 (dy) inxhinier me përvojë pune minimumi 5 vite në këtë lëmi;
 - 5 (pesë) ekspert në montim, konfigurim.
2. Autoriteti Kontraktues, ka favorizuar një operator ekonomik, duke kërkuar
 - Autorizim (MAF) nga prodhuesi ose dileri autorizuar (nëse autorizimi është nga dileri duhet të sillet si dëshmi kontrata dhe autorizimi (MAF) për shitjen e produkteve që ofrohen për këtë projekt. Nëse pajisjet për monitorimin e automjeteve dhe ato për matjen e derivateve janë të ndryshëm duhet të ofrohen MAF tjetër.
3. Autoriteti Kontraktues, ka favorizuar një operator ekonomik, duke kërkuar
 - Që operatori ekonomik të dorëzojë pajisjet harduerike të certifikuara me ISO 14001 2015, ISO 9001 2015, ISO 45001 2018, dhe softueri po me të njëjtat certifikime. ISO14001 2015

Përgjigje në pretendimin 2:

Eksperti shqyrtues i prokurimit lidhur me këtë pretendim ankimor, konsideron se AK është dashur ta precizoj saktë në dosjen e tenderit se a bëhet fjalë për sistem të ri të menaxhimit të Automjeteve apo të vazhdojë mirëmbajtjen dhe shtimin e këtij ekzistuesit.

Tek paragrafi i parë i pretendimit ankimor 2 konsideroj se për kontrata të tilla dhe numrin e automjeteve të përfshira është i mjaftueshëm numri i kërkuar i stafit profesional dhe të kualifikuar sipas kërkesave të AK-së. Madje edhe në rast të mirëmbajtjes së sistemit, andaj këtë pjesë të pretendimit ankimor e konsideroj si pretendim të pa bazuar.

Tek paragrafi i dytë i pretendimit ankimor 2 lidhur me kërkesën për MAF dhe DAF konsideroj se është e pa nevojshme, kjo sepse pajisjet janë në pronësi të AK-së dhe ata si pronar mund të ofrojnë qasje në to. Kjo pjesë e pretendimit ankimor 2 konsideroj se duhet të aprovohet si e bazuar.

Tek paragrafi i tretë i pretendimit ankimor 2 lidhur me kërkesën për certifikim të produkteve me ISO standarde, AK është dashur të kërkojë certifikata për OE konkurrues dhe stafin e tij, e jo për produktet të cilat tashmë i posedon AK.

Po ashtu, për mendimin tim certifikimet e kërkuara të produkteve nuk janë fare relevante me qëllimin e projektit, ngase ISO 14001 2015 është certifikim që specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor që një organizatë mund të përdorë për të përmirësuar performancën e saj mjedisore (pra është certifikim i OE e jo i produktit), si dhe ISO 45001 2018 rezulton të jetë certifikim për sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, pra këto certifikime ne konsiderojmë që nuk janë relevante me qëllimin e projektit, për mendimin tim do të mjaftonte certifikimi ISO 9001 2015 i cili standard specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë të shërbimeve brenda një ndërmarrje/organizate.

Pretendimin 2 në tërësi e konsideroj si pjesërisht të bazuar dhe si të tillë i propozoj që të aprovohet nga ana e Panelit Shqyrtues të OSHP-së.

Pretendimi Ankimor 3:

Autoriteti Kontraktues ka shkelur Paragrafin 2 dhe 6 tek Neni 108/A, të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092, sepse:

Nuk është pezulluar aktiviteti i prokurimit me rastin e parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim dhe nuk është kthyer përgjigje nga ana e AK-së.

Përgjigje në pretendimin 3:

Eksperti shqyrtues i prokurimit lidhur me këtë pretendim ankimor konsideron se AK duke mos e bërë pezullimin e procedurës me rastin e pranimit të kërkesës për rishqyrtim ka bërë shkelje të nenit 108/A paragrafit 2 si dhe duke mos kthyer përgjigje në kërkesën për rishqyrtim brenda tre (3) ditësh pune nga data e dorëzimit (ka kthyer përgjigje me datë 07.11.2022, 6 ditëpas dorëzimit) ka bërë shkelje të nenit 108/A paragrafi 6 këtij neni. Ky afat, në raste specifike të justifikuar mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe OE parashtrues i kërkesës do të informohet për këtë, mirëpo eksperti shqyrtues nuk ka hasur në ndonjë arsyetim për vonesë.

Propozojmë që pretendimi ankimor 3 të aprovohet si i bazuar nga ana e Panelit Shqyrtues të OSHP-së.

Propozojmë që Paneli Shqyrtues i OSHP-së ta aprovoj si të bazuar në tërësi ankesën e OE ankues dhe të sjellë vendim që të anulohet ky aktivitet i prokurimit, ndërsa AK, me rastin e ri tenderimit të tij të ketë parasysh asetet ekzistuese me të cilat tashmë posedon, ashtu që ri tenderimi të bëhet duke marrë parasysh nenet 1, 6 dhe 7 të LPP-së e sidomos duke i kushtuar rendësi të veçantë shfrytëzimit optimal të buxhetit.

Konform nenit 24 paragrafi 1 i Rregullores së Punës së OSHP-së 01/2020 e datës 03.03.2022 (e amendamentuar), paneli shqyrtues ka vlerësuar se në shkresat e kësaj lënde ka argumente dhe prova të mjaftueshme që vendimi meritohet të merret edhe pa dëgjimin e palëve në seancë.

Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues në këtë rast sa i përket kërkesave të vendosura në Dosje të Tenderit që ndërlidhen me pretendimeve ankimore, janë në kundërshtime me nenin 7 të LPP-së, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi. Andaj, AK duhet të bëjë përmirësimet e dosjes së tenderit dhe të shtyjë afatin për ofertim konform nenit 53.7 të LPP-së.

Andaj nga te lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues
Kimete Gashi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 Komuna e Prishtinës
- 1x1 "BBROS L.L.C" ,me seli ne Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.